



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1139**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi – Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE "3D ProCon" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjet sanitare në IEAA dhe objektet e tjera komunale” me numër të prokurimit 616-24-11742-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më 17/01/2025, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e OE "3D ProCon" SH.P.K. me nr. 2024/1139, e datës 22/11/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjet sanitare në IEAA dhe objektet e tjera komunale me numër të prokurimit 616-24-11742-5-2-1 (AK) -Komuna e Prishtinës.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.11.2024 Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjet sanitare në IEAA dhe objektet e tjera komunale” me numër të prokurimit 616-24-11742-5-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është në procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 89,28211 euro.

Me 16.11.2024 OE "3D ProCon" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.11.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.11.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "3D ProCon" SH.P.K. me nr. 1139/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjet sanitare në IEAA dhe objektet e tjera komunale me numër të prokurimit 616-24-11742-5-2-1.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

### ***Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "3D ProCon" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:***

*Pretendimi i parë: Diskriminimi përmes kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional: Ankesa bazohet në faktin se kërkesat për inxhinierët e ndërtimitarisë, hidroteknikës dhe elektronikës janë shumë të ngushta dhe të panevojshme për natyrën e kontratës. Për shembull, kërkesa për inxhinier të ndërtimitarisë që duhet të ketë certifikime të shumta dhe eksperiencë të gjerë përfshin detyra që janë të panevojshme për llojin e projektit, duke kufizuar kështu konkurrencën dhe duke favorizuar operatorë të caktuar. Po ashtu, kërkesa për inxhinierin e hidroteknikës për certifikime që lidhen me testimin e performancës së produkteve të ndërtimit nuk duket relevante për këtë projekt, dhe mund të ndikojë negativisht në hapjen e mundësive për operatorët e tjerë.*

*Pretendimi i dytë: Kërkesat e panevojshme për paisje dhe makineri-*

*Kërkesat për paisje si ngarkues dhe gjenerator janë të diskutueshme, duke qenë se ato nuk janë të nevojshme për natyrën e punës që do të kryhet. Kjo është një tjetër mundësi për të kufizuar konkurrencën dhe mund të favorizojë operatorë që tashmë i kanë këto paisje.*

*Pretendimi i tretë: Përputhshmëria me ligjin dhe rregulloret- Ankesa thekson se këto kërkesa bien në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik (LPP), duke shkelur parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës të hapur. Disa paragrafë të ligjit (si nenet 7 dhe 51) janë cituar për të mbështetur pretendimet që kërkesat janë diskriminuese dhe të paarsyeshme për të përmbushur objektivin e kontratës dhe për të siguruar një procedurë prokurimi të drejtë dhe transparente.*

*Pretendimi i katërt : Kërkesa për rishqyrtim të kritereve- Pasi që këto kërkesa janë konsideruar të panevojshme dhe të favorshme për disa operatorë të caktuar, është kërkuar nga autoriteti kontraktues që ato të rishikohen dhe të modifikohen për të mundësuar një konkurrencë më të hapur dhe për të shmangur diskriminimin.*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "3D ProCon" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,27,51,69, të LPP-se.

**Përgjigje nga AK në kërkesën për rishqyrtim:** "Operatori ekonomik "3D ProCon" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rënovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjet sanitare në IEA A dhe objekte tjera komunale", me.nr. të prokurimit 616-24-11742-5-2-1.Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in meritum) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** "P.1. - "Kërkojmë nga ju që të ndryshoni kërkesën duke i larguar certifikimet e kërkuara për inxhinierin e Ndërtimtarisë, ndoshta ta ndërroni edhe profilin e menaxherit të projektit, pasi që ska të bëjë asgjë menaxheri me këtë profil në këtë kontratë, pasi që siç e cekëm kërkesa e tillë favorizon një OE të caktuar dhe diskriminon OE që janë të interesuar për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Ne kërkojmë që ky kriter të hiqet, sepse për këtë kontratë as që nevojitet një inxhinier i tillë.

Lidhur me këtë pretendim AK përgjigjet- Kërkesa për menaxher të projektit si e tillë është sa bazike aq edhe e domosdoshme për realizimin me sukses të projektit të cilit i referohet ky aktivitet i prokurimit. Profili profesional i menaxherit të projektit është profili më i përshtatshëm dhe njëkohësisht më i rëndësishëm për realizimin e projekteve të natyrës, qëllimit, por dhe kompleksitetit që e manifeston edhe në rastin konkret. Rrjedhimisht, pretendimi është i pabazuar."

P.2. - "Në lidhje me certifikimet për specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit, shihet qartë tendenca për favorizim, pasi që në këtë kriter nuk dihet a po kërkohet inxhinier apo laborator i testimit. Si është e mundur që inxhinieri i Hidroteknikës me një certifikatë të përcaktojë performancën e produkteve të ndërtimit, pasi që kur flasim për ndërtimin kemi të bëjmë me një profil shumë të gjerë ku përfshihen shumë produkte?"

Lidhur me këtë pretendim AK përgjigjet: Cilësia e lartë e produkteve është një nga parakushtet kryesore për realizimin me sukses të projektit për të cilin po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit. Rrjedhimisht, testimi i performancës së produkteve të ndërtimit është kërkesë absolutisht e domosdoshme, prandaj edhe e pandryshueshme për këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht, pretendimi është i pabazuar."

P.3. - "Tek kërkesa nr. 4 e kapacitetit teknik dhe profesional, ju e keni kërkuar edhe një (1) inxhinier i diplomuar i Elektronikës, dega automatike me elektronike, me së paku pesë (5) vite përvojë pas diplomimit. Kështu siç e keni specifikuar kërkesën e lartpërmendur, ju e keni kufizuar konkurrencën jashtëzakonisht shumë. Ju e keni specifikuar saktë inxhinierin e Elektronikës, dega Automatike me Elektronikë. Si AK, ju lutem vetëm na përshkruani pozicionet për të cilat është përgjegjës ky inxhinier."

Lidhur me këtë pretendim AK përgjigjet: Kërkesa për inxhinier të elektronikës është në përputhje jo vetëm me paramasën, por edhe me qëllimin dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit. Shih poz.

92, 93, 94, etj. të paramasës. Prandaj edhe kjo kërkesë mbetet e pandryshuar, ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

*P.4. - "Kërkesa e lartpërmendur kërkojmë të sqarohet Aneksi 8, përkatësisht pika 5. Çfarë makinerie për bartje të materialeve? - Ngarkues-Ult- pse është i nevojshëm ky ngarkues për këtë lloj pune? - Një gjë tjetër, faktor elektrik 10kr - pse është i nevojshëm ky kriter, kur dihet që në të gjitha shkollat e KK Prishtinës ka energji elektrike?"*

*Lidhur me këtë pretendim AK përgjigjet: Makineria/pajisjet e kërkuara për këtë aktivitet të prokurimit janë pajisje themelore (bazike) dhe absolutisht të domosdoshme për realizimin e pozicioneve përkatëse në paramasë. Pa këto pajisje rrezikohet në mënyrë esenciale realizimi me sukses i projektit që synohet të ekzekutohet. Prandaj, pretendimi ankimor është i pabazuar, ndërsa kërkesa mbetet e pandryshuar”.*

*Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet cekur se përmes nenit 10, paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11, paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera, në bashkëpunim me njësinë kërkuuese, i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka pasur besimin e plotë në sqarimet e ofruara nga njësia kërkuuese.*

*Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”*

#### **- Administrimi dhe vlerësimi i provave –**

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 22/11/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1139/2024, ndërsa me datë 05/12/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1139 me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.*

***Lidhur me pretendimet e OE "3D ProCon" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1139 ka vlerësuar si në vijim:***

*“Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues, pretendon se kërkesat e aplikuara nga ana e AK-se për stafin nuk janë në përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve / dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosje të tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale kishte aplikuar kërkesat si në vijim; -Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare*

*Kërkesa 1 - Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjajshme kombetare apo nderkombetare, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 150 000.00 Euro*

Dëshmia 1 - Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Kërkesa 2 - Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv me me se paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar mbrojtja dhe siguri në punë, I certifikuar mbrojtja nga zjarri dhe nderhyrja ndaj emergjencave, I certifikuar për efikasitet të energjisë, I certifikuar sipas standartit 9001 2015 Lead Auditor dhe sipas standartit 45001 2018 Lead Auditor.

Dëshmia 2 - CV-a e nënshkruar nga vete personi, Diploma e noterizuar nga vet inxhinjeri, Kontrata e punës me punëdhënesin ose parakontrata mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe certifikatat e kërkuara sipas kërkesës 2.

Kërkesa 3 - Një (1) inxhinier i diplomuar i hidroteknikës ose master i diplomuar me se paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe certifikat specjelist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit.

Dëshmia 3 - CV-a e nënshkruar nga vete personi, Diploma e noterizuar nga vet inxhinjeri, Kontrata e punës me punëdhënesin ose parakontrata mbi angazhimin për këtë projekt. Certifikatat e kërkuara sipas kërkesës 3.

Kërkesa 4 - Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektros dega automatike me elektronike me se paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 4 - CV-a e nënshkruar nga vete personi, Diploma e noterizuar nga vet inxhinjeri, Kontrata e punës me punëdhënesin ose parakontrata mbi angazhimin për këtë projekt.

Kërkesa 5 - Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitektures së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 5 - CV-a e nënshkruar nga vete personi, Diploma e noterizuar nga vet inxhinjeri, Kontrata e punës me punëdhënesin ose parakontrata mbi angazhimin për këtë projekt.

Kërkesa 6- OE duhet të ketë njëzet (20) puntor të deklaruar në ATK të angazhuar për këtë projekt

Dëshmia 6 - për stafin e rregullt - puntoret të ofrohen dëshmi se janë në listë të ATK-es në 12 muajt e fundit, ndërsa për stafin që do të angazhohen vetëm për këtë projekt të ofrohen kontrata ose parakontrata të noterizuara në prani të palëve.

Kërkesa 7 - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti sipas aneksit 8. Dëshmia 7- Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofrojë Librezat kopje, Dokumentin Unik Duganor për makinerit që nuk kanë Librezat. Nëse nuk ekziston DUD, OE duhet të sjellë faturat e blerjes me dëshmi bankare. Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të paisjeve, duhet të ofrohet Marrëveshja për shfrytëzimin e pajisjeve për këtë projekt (nuk pranohen marrëveshjet e përgjithshme) dhe dëshminë mbi paisjet (Librezat kopje, Dokumentin Unik Duganor për makinerit që nuk kanë Librezat, Nëse nuk ekziston DUD, OE duhet të sjellë faturat e blerjes me dëshmi bankare. Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të paisjeve, duhet të ofrohet Marrëveshja për shfrytëzimin e pajisjeve për këtë projekt (nuk



pranohen marrëveshjet e përgjithshme) dhe dëshminë mbi paisjet (Librezat kopje, Dokumentin Unik Duganor për makinerit që nuk kanë Libreza, nëse nuk ekziston DUD, OE duhet të sjell faturat e blerjes me dëshmi bankare, (AK ruan te drejten e vizites ne terren per verifikim te paisjeve nese është e nevojshme)

Kërkesa8 – OE duhet te kete puntor te kualifikuarsi nje (1) ushtrus i pllakave, Nje (1) Hidroizolues,

Dëshmia 8 - Kontratë apo parakontrate me puntoret e kualifikuar per projektin e caktuar si dhe qertifikatat e noterizuara nga ndonje shkollë profesionale kombetare apo nderkombetare.

Kërkesa 9 - OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” ne baze te rikapitullimit duhet të shënohet data e fillimit dhe data e përfundimit dhe kohëzgjatja, numri I ditëve të nevojshme për rikapitullim të caktuar. Gjithashtu, së paku në rreshtin e fundit, të shënohen të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe stafit të OE të angazhuar në punishte në ditën apo datën e caktuar në “Planin Dinamik”. Në planin dinamik të shënohen ditët e pushimit (ditët e diela) si dhe ditët e festave sipas kalendarit të festave të Republikës së Kosovës

Dëshmia 9 - Planit dinamik duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE

Pas shqyrtimit të provave shkresore vlerësojmë se kërkesat e kontestuara nga OE ankues – sa i përketë dëshmimeve të kërkuara nga ana e AK-se tek kapacitetit teknik dhe profesional, janë në përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe AK si në përgjigjen e dhënë ndaj kërkeses për sqarime shtese poashtu edhe në arsyeshmërinë e vendimit kur e ka refuzuar kërkesen për ri-shqyrtim, ka arsyetuar kërkesat e vendosura në dosje të tenderit duke i harmonizuar me pozicionet e paramases dhe paralogarise. Në rastin konkret, vlerësojmë se AK, ka vendosur kritere që kanë të bëjnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit bazuar në paramasen dhe paralogarinë për punët që do të realizohen përmes këtij aktiviteti. Po ashtu vlenë të ceket fakti se AK, ka sqaruar kërkesat e vendosura në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, fillimisht përmes sqarimeve të ofruara dhe mëpastaj edhe në arsyeshmërinë e vendimit mbi refuzimin e kërkeses për ri-shqyrtim për të gjitha pretendimet e ngritura nga ana e OE ankues. AK në sqarimet e ofruara ka konfirmuar se kërkesat për profilet e inxhinerëve janë të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit të cilit i referohet ky aktivitet i prokurimit. Profili profesional i menaxherit të projektit është profili më i përshtatshëm dhe njëkohësisht më i rëndomtë për realizimin e projekteve të natyrës, qëllimit por dhe kompleksi tetit që e manifestohet edhe në rastin konkret. Kurse sa i përketë certifikimeve të kërkuara AK ka sqaruar se për të arritur cilësinë e lartë e produkteve është një nga parakushtet kryesore për realizimin me sukses të projektit për të cilin po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit. Rrjedhimisht testimi i performancës së produkteve të ndërtimit është kërkesë absolutisht e domosdoshme prandaj edhe e pandryshueshme për këtë aktivitet të prokurimit”. Andaj në përputhje me konstatimet me më sipërme vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë janë të paqenëdrueshme.

Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se bazuar në nenin 17.15 të rregullores për prokurimin publik nr 001/22, vendosja e kritereve të përzgjedhjes është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vendosja e kritereve të bëhet në harmoni të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

### *- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "3D ProCon" SH.P.K., të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Renovimi i rrjetit te ujësjellësit, kanalizimit ne nyjet sanitare ne IEAA dhe objektet e tjera komunale." me numër të prokurimit 616-24-11742-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - 3D ProCon SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: